

VENDIM
Nr.15, datë 11.3.2005

**PËR KOMPENSIMIN E KONSUMATORËVE NDAJ TË CILËVE NUK JANË ZBATUAR
VENDIMET E ERE-S PËR VLERAT E FATURIMIT AFORFE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 3, germa b, ç dhe g, 9 dhe 26 pika 1 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 11.3.2005, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun, për inspektimin e kryer në lidhje me zbatimin e vendimeve të ERE-s për vlerat e faturimit aforfe në konsumatorët familjarë, pa aparat matës ose me matës jashtë kushtit teknik,

KONSTATON:

KESH sh.a. ka shkelur në mënyrë të përsëritur vendimet e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.12, datë 29.10.2002 “Për vlerat e faturimit aforfe për konsumatorët familjarë që nuk kanë aparat matës” për periudhën e dimrit 1 tetor 2003–31 mars 2004 dhe nr.23, datë 30.4.2004 “Për miratimin e sasisë së energjisë elektrike të përlllogaritur për t’u faturuar aforfe për abonentët familjarë pa matës ose me matës jashtë kushtit teknik” për periudhën 1 prill 2004–30 shtator 2004, si dhe nenin 6 të kontratës për furnizimin me energji elektrike për konsumatorët të kategorisë familjarë.

VENDOSI :

1. KESH sh.a., për konsumatorët ndaj të cilëve nuk janë respektuar vlerat e faturimit aforfe të vendosur nga Bordi i Komisionerëve të ERE-s, të bëjë kompensimin në sasi dhe vlerë të energjisë elektrike, në faturat e muajve pasardhës deri në likuidimin e plotë të kësaj vlere.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare .

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema